



## PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 15.08.2024 në Shkollën Filllore “Kështjella e Diturisë” në fshatin Paldenicë. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 13:30 prezent ishin 13 qytetarë. Prezent ishte Nënkryetari i Komunës z. Sevdî Dernjani.

Takimin e kryesoj Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znj. **Lindita Ballazhi**.

### Rendi i Punës

#### 1. Projekt Buxheti për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027.

**Lindita Ballazhi** para se me vazhduar me prezantimin e buxhetit fillimisht kërkoj nga nënkryetari i Komunës për një fjalë përshëndetëse, pastaj do të bëjë prezantimin e buxhetit.

**Sevdî Dernjani** është obligim ligjorë që të organizojmë dëgjim buxhetorë për planifikimin buxhetorë për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027. Por më gjerësisht dhe në mënyrë të detajuar drejtoresha do ta paraqet.

**Lindita Ballazhi** Buxheti paraqet një instrument financiar apo një plan njëvjeçar për ecurinë e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore të Organizatës Buxhetore. Fazat nëpër të cilat i kemi kaluar deri në hartimin e buxhetit janë:

- Themelimi i 2 grupeve punuese: Grup punues për hartimin e dëgjimeve buxhetore dhe Grupi punues për hartimin e KAB-it 2025-2027.
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 01/2025 me kufijtë fillestar buxhetor,
- Hartimi i KAB-it me grupin punues,
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore për KAB 2025-2027,
- Miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i KAB-it në Departamentin e Buxhetit - MFPT,
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 02/2025 me kufijtë final buxhetor,
- Hartimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Mbajtja e Dëgjimeve Buxhetore për Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Dorëzimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 para datës 01.09.2024 në Kuvend Komunal,
- Miratimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Departamentin e Buxhetit - MFPT.

Buxheti për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ky buxhet është ndarë në kategoritë buxhetore. Për paga dhe shtesa buxheti i planifikuar është në shumë prej 2,188,542.00€, mallra dhe shërbime 584,500.00€, shpenzime komunale 94,000.00€, subvencione dhe transfere në shumë prej 143,000.00€, investime kapitale 605,415.00€. Sa i përket listës së projekteve kapitale, i kemi listuar të gjitha projektet të cilat janë miratuar nga Asambleja Komunale në KAB 2025-2027, po ne jemi të hapur edhe për propozime të reja. Më pas do të hartojmë Listën e propozimeve të qytetarëve dhe të njëjtën listë do ta dorëzojmë së bashku me Buxhetin në Kuvend Komunal për shqyrtim dhe aprovim të mëtutjeshëm.

**Sadam Dernjani** propozoj që të bëhet rregullimi i prockave.

**Ahmet Krasniçi** propozoj që të hiqet trotuari i rrugës prej shkollës deri në pjesën e poshtme për shkak se rruga është shumë e ngushtë dhe rruga të zgjerohet.


**Xhevahir Dernjani** propozoj që të bëhet trotuari prej shkollës deri te shtëpia e pritjes. Propozoj që të rregullohet rruga Fujza-Vërtomicë.

**Lindita Ballazhi** a keni edhe ndonjë propozim përveç këtyre propozimeve , nëse nuk ka propozimet që u parashtruan do t'i analizojmë si ekzekutiv dhe do t'i përcjellim për Kuvend.

Debati përfundoi në ora 13:53.

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**



**Drejtoresh për Buxhet dhe Financa**

**Lindita Ballazhi**

